



**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

TETOR 2021

Buletini MuJOR i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin MuJOR bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës MuJore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin tetor 2021 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në të gjitha bashkitë e vendit.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit tetor 2021 zënë 29.5 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 146.37/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 1.95/100.000 banorë. Rrethet Berat, Kukës dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë muajit tetor 2021 NJVKSH Shkodër ka raportuar 5 raste (Incidenca 3.68/100.000 banorë) të konfirmuara me Salmonelozë jotifoide. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin tetor 2021 në nivel kombëtar 5 raste të konfirmuara (Incidenca 3.68/100.000 banorë) dhe një rast i dyshuar është raportur nga NVKSH Lezhë.

**Tabela 1: Frekuencat dhe incidentat e sëmundjeve diarreike për muajin tetor 2021
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste tetor 2021	Incidenca tetor 2021 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	5	0.17
Shigelozë (Disenteri bacilare)	6	0.2
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	56	1.95
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	4123	14403
Sëmundje diarreike në total	4190	146.37

2. Sëmundjet e EPI

2.1 Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit tetor 2021 janë raportuar 10 raste (Incidenca 0.34/100.000 banorë) me tuberkuloz pulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike, 10 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Rastet janë të shpërndara në të gjithë vendin përkatësisht nga Tirana, Lezha dhe Bulqiza.

Gjatë muajit gusht 2021 janë raportuar 4 raste me Tuberkuloz ekstrapulmonar, përkatësisht 2 në Tiranë dhe 2 në Lushnjë. Nga ekzaminimet laboratorike 4 raste janë konfirmuar sputum pozitiv Konfirmimi është kryer në Laboratorin e Referencës, Tiranë. Për rastet pozitiv është lajmëruar dispanseria përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse.

4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit tetor 2021 janë raportuar në total 23 raste me hepatit viral B të konfirmuar (Incidenca 4.12 /100.000 banorë) të raportuara nga NJVKSH Tiranë.

Në muajin tetor 2021 janë raportuar 4 raste të konfirmuara (Incidenca 0.71/100.000 banore) me Hepatit Viral as A as B, të raportuara nga NJVKSH Tiranë.

5. HIV/AIDS

Në muajin tetor 2021 janë kryer në total 40 ekzaminime për HIV në “Njësinë e Laboratorëve” në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP). Nga këto ekzaminime 11 prej tyre kanë rezultuar pozitive (8 meshkuj dhe 3 femra). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme nga 36 deri 58 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Durrës Korçë dhe Tepelenë. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur në ISHP nga QSUT (Spitali Infektiv), QKTGJ, vullnetarë, laborator privat (GENIUS) dhe shoqata të ndryshme.

INSTITUTI I
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI